

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 7 KORRIK 2022

Zotërinj deputetë,

Zonja deputete,

Zonja Kryetare e parlamentit,

Zoti Ambasador,

Të dashur qytetarë dhe qytetare të Shqipërisë,

Sot vendi im mund të ishte kudo tjetër, por jo në këtë parlament, i cili është një nga shkaqet më madhore të revoltës së përgjithshme popullore që do të nisë sot në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe do të ndalet vetëm me rrëzimin përfundimtar të regjimit të monizmit të plotë, të autokracisë elektorale të Edi Ramës. Gjenocidi, si forma më e urryer, më e rëndë e krimeve kundër njeriut dhe njerëzimit, nuk mund të mos më sillte mua këtu për ta dënuar me forcën më të madhe barbarinë serbe ndaj popullit boshnjak, njëkohësisht, barbaritë serbe në rajon.

Pasi refuzuat në mënyrën më absurde një rezolutë të paraqitur nga opozita një muaj më parë, ju sollët këtu në parlament një rezolutë, të cilën unë e vlerësoj, për sa kohë ajo dënon gjenocidin, por rezoluta juaj, dua ta them që në fillim, është një rezolutë e njerëzve zemërthyer, e njerëzve me qëndrim të dyfishtë. Nga një anë ju dënoni gjenocidin, dhe kjo është pamohueshme, por, nga ana tjetër, fshihni me qëllim ideologun, arkitektin e gjenocidit në Bosnjë Slobodan Millosheviçin dhe sivëllanë e Edi Ramës, Aleksandër Vuçiçin. Si mund ta bëni ju këtë, kur në gjitha mediet e botës ekziston deklarata në parlament, por edhe në Bosnjë, e Aleksandër Vuçiç, i cili udhëzon dhe zotohet se për çdo serb të vrarë do të vriten 100 myslimanë?!

A e kuptoni ju apo jo se Aleksandër Vuçiç ka vetëm një vend dhe ai vend është Haga? Ju jo vetëm nuk guxonin të kërkoni dërgimin e tij urgjent në Hagë dhe gjykimin e tij për gjenocid, por

bëni gjithçka për ta kufizuar në forcat serbe në Bosnje, madje pa iu referuar edhe kasapëve të Bosnjës, Milladiçit dhe Karaxhiçit. Sa ju nderon ju kjo? Pse bëni strucin? Çfarë ju shtyn ju të mos jeni të hapur dhe ta dënoni me gjithë shpirt, me gjithë zemër masakrën më të madhe që ka njohur Europa, pas Luftës së Dytë Botërore. Çfarë ju shtyn të fusni një frazë, e cila është një aktakuzë shumë e rëndë për ju dhe Edi Ramën, ku flisni për vrasjet në Kosovë dhe jo gjenocid në Kosovë? Çfarë është kjo? Çfarë është ky kapitullim? Çfarë është ky nënshtrim juaji? Nuk keni qenë në gjendje as të perifrasoni rezolutën e Parlamentit European, i cili ka kompozim anglosakson, neolatin, sllav, por kanë rënë në ujdi që t'u referohen forcave paramilitare, xhelatëve të policisë serbe, të Beogradit, që shkoi të therë, të vrasë myslimanë, boshnjakë në Bosnje.

Çfarë e keni këtë kompleks? Pse kreu juaj është shndërruar në një tellall dhe vasal të Aleksandër Vuçiçit, apo, sepse edhe ndiqni edhe ju “Ballkanin e hapur”; “Ballkanin e hapur” për krimin, “Ballkanin e hapur” për Serbinë, për hegjemoninë serbe, për influencën ruse? Ju edhe ndaj gjenocidit rus në Ukrainë mbani një qëndrim dyfytyrësh. Nga njëra anë e dënoni, nga ana tjetër, pranoni turistë, vrasësit, përdhunuesit, ekzekutuesit e fëmijëve, grave dhe burrave të pafajshëm ukrainas. Po, po i pranoni këtu këta barbarë për ta rimarrë veten në plazhet e Shqipërisë. Me urdhër të kujt i pranoni këtu? Me urdhër të Vuçiçit dhe të Lavrovit. Ndaj, rezoluta duhet të ndalojë përfundimisht çdo turist rus të shkelë në territorin e Shqipërisë.

Nga njëra anë, ju nuk pranoni të dënoni Vuçiçin, i cili është filmuar duke deklaruar se për çdo serb të vvarë, do të vriten 100 myslimanë, njëlloj si në rregullin e Gestapos, nga ana tjetër, flisni për Ukrainën, por pranoni në Shqipëri xhelatët rusë, që vijnë nga Beogradi, me linjën ajrore të Serbisë, e cila e bën 18 herë në javë rrugën Moskë – Beograd. A keni ju një marrëveshje të fshehtë turizmi për të pranuar vrasësit? Më thoni: a mund të pranohen ata që kanë kryer krime në Ukrainë, ata që i kanë duart me gjak, që vijnë nga Mariupoli, nga Bucha dhe nga Luhanski? Ndaj, rezoluta për dënimin e gjenocidit serb është domosdoshmëri, por ju e keni me zemër të thyer.